

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara

SKK 13 Aktivet biologjike dhe marrëveshjet konçesionare

Pg.		Paragrafët
	STANDARDI KOMBËTAR I KONTABILITETIT NR. 13 –AKTIVET BIOLOGJIKE DHE MARRËVESHJET KONÇESIONARE– I PËRMIRËSUAR	
	PËRMBAJTJA	
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES	1-3
	FUSHA E ZBATIMIT	4
	AKTIVET BIOLOGJIKE	5-22
	Përkufizimet kryesore	5-7
	Politikat kontabël për aktivet biologjike	8
	Njohja fillestare	9-11
	MATJA DHE VLERËSIMI I MËPASHHËM	12-22
	Matja-Modeli i vlerës së drejtë	12-14
	Matja-Modeli i kostos	15-16
	Zhvlerësimi i aktiveve biologjike të mbajtura me kosto	17-20
	Çregjistrimi	21
	Paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e performancës të aktiveve biologjike	22
	MARRËVESHJET KONÇESIONARE	23-28
	Konçesionet e shërbimeve	23-24
	Modeli i aktivitetit financiar	25
	Modeli i aktivitetit jomaterial	26
	Të ardhurat operative	27
	Paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e performancës të marrëveshjeve konçesionare	28
	SHËNIMET SHPJEGUESE	29-32
	Shënimet shpjeguese për aktivet biologjike	29-30
	Aktivitetet biologjike të mbajtura me vlerë të drejtë	29
	Aktivitetet biologjike të mbajtura me kosto	30
	Shënimet shpjeguese për marrëveshjet konçesionare	31-32
	Modeli i aktivitetit financiar	31
	Modeli i aktivitetit jomaterial	32
	DISPOZITA KALIMTARE	33
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	34
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME (SNRF PËR NVM)	35
	BAZA E KONKLUSIONEVE	
	UDHËZUES PËR ZBATIMIN E SKK 13	
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES	
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 13, <i>Aktivitetet Biologjike dhe Marrëveshjet Konçesionare</i> (‘SKK 13’ ose ‘Standardi’), nxjerrë dhe miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe i shpallur nga Ministria e Financës, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpashhëm për aktivitetet biologjike dhe marrëveshjet konçesionare si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përshkruhen në Ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Nr. 9228 , publikuar në prill 2004, i ndryshuar.	
2	SKK 13 mbështetet në SNK 41, <i>Bujqësia</i> . SKK 13 është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 34 <i>Aktivitetet e</i>	

	<p><i>Specializuara të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Njësitë e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për NVM-të është dhënë në paragrafin 35. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 13 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare së njësisë ekonomike raportuese, siç kërkohet në nenin 9 të Ligjit nr. 9228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar.</i></p>
3	<p>Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 40 deri 90 të SKK 1.</p>
	<p>FUSHA E ZBATIMIT</p>
4	<p>Ky Standard do të zbatohet për:</p> <p>(a) aktivet biologjike (përfshirë të gjitha aktivet biologjike, përveç tokave të përdorura për veprimtari bujqësore (shiko SKK 5, <i>Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale</i>) dhe prodhimin bujqësor, i cili kontabilizohet si inventar që nga momenti i vjeljes (shiko SKK 4, <i>Inventarët</i>), dhe</p> <p>(b) marrëveshjet konçesionare.</p>
	<p>AKTIVET BIOLOGJIKE</p>
	<p>Përkufizimet kryesore</p>
5	<p>Më poshtë jepen përkufizimet e termave kryesore të përdorura në këtë standard:</p> <p><u>Aktiviteti bujqësor</u> është menaxhimi nga ana e një njësie ekonomike i transformimit biologjik të aktiveve biologjike në prodhim bujqësor për shitje ose në aktive të tjera biologjike.</p> <p><u>Prodhimi bujqësor</u> është prodhimi i vjelë nga aktivet biologjike të njësisë ekonomike.</p> <p><u>Aktivi biologjik</u> është një kafshë e gjallë ose bimë.</p> <p><u>Transformimi biologjik</u> përfshin proceset e rritjes, shndërrimit, prodhimit dhe mbarështimit që sjellin ndryshime cilësore e sasiore në aktivin biologjik.</p> <p><u>Vlera kontabël neto</u> është shuma, me të cilën një aktiv biologjik njihet në pasqyrën e pozicionit financiar (pasi zbritet amortizimi i akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvlerësimi).</p> <p><u>Amortizimi</u> është shpërndarja sistematike e vlerës së amortizueshme të një aktivi biologjik, përgjatë jetës së tij të dobishme.</p> <p><u>Vlera e amortizueshme</u> është kostoja e një aktivi ose një vlerë tjetër që zëvendëson koston, minus vlerën e rikuperueshme të aktivit.</p> <p><u>Jeta e dobishme</u> është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - periudha, gjatë së cilës një aktiv pritet të përdoret nga njësia ekonomike; - numri i produkteve (ose njësi të tjera të ngjashme) që njësia ekonomike pret të përftojë nga përdorimi i aktivit. <p><u>Kostoja</u> është shuma e mjeteve monetare ose ekuivalenteve të mjeteve monetare e paguar, ose vlera e drejtë e aktiveve të tjera të dhëna për të blerë një aktiv në kohën e blerjes apo të prodhimit të tij.</p> <p><u>Vlera e rikuperueshme</u> është shuma e vlerësuar që njësia ekonomike pret të përftojë nga një aktiv në fund të jetës së tij të dobishme, pas zbritjes së kostos së nxjerrjes nga përdorimi.</p> <p><u>Humbja nga zhvlerësimi</u> është shuma, me të cilën vlera kontabël e një aktivi ose një njësie gjeneruese parash e tejkalon shumën e tij të rikuperueshme.</p> <p><u>Shuma e rikuperueshme</u> është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktivi (pakësuar me koston e shitjes) dhe vlerës së tij në përdorim.</p> <p><u>Vlera në përdorim</u> është vlera aktuale e flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare, që pritet të vijë nga përdorimi i një aktivi ose nga dalja e tij jashtë përdorimit në fund të jetës së tij të dobishme.</p>
6	<p>Aktivitet biologjike duhet të dallohen nga prodhimi bujqësor i cili kontabilizohet si inventar (shiko SKK 4, <i>Inventarët</i>). Aktivet biologjike janë kafshë ose bimë të gjalla, si bagëti, pemë dhe vreshta. Prodhimi bujqësor, si leshi, lënda drunore dhe rrushi janë prodhime të marra nga aktivet biologjike.</p>
7	<p>Aktivitet biologjike nuk quhen ato që merren nga burime që nuk administrohen nga dora e njeriut, si për shembull peshku në det. Në fakt, aktivet biologjike janë produkt i një procesi të kontrolluar nga një njësi ekonomike për administrimin e rritjes dhe</p>

	maturimit të tyre. Aktivet biologjike mund të shiten, transformohen në prodhim bujqësor ose aktive të tjera biologjike.
	Politikat kontabël për aktivet biologjike
8	Një njësi ekonomike përdoruese e këtij standardi, që është përfshirë në aktivitet bujqësor, duhet të përcaktojë politikën e saj kontabël për çdo klasë të aktiveve biologjike si më poshtë: (a) Njësia ekonomike duhet të përdorë modelin e vlerës së drejtë në paragrafët 12-14 për ato aktive biologjike për të cilat vlera e drejtë është menjëherë e përcaktueshme pa kosto apo përpjekje të tepërta; (b) Njësia ekonomike duhet të përdorë modelin e kostos në paragrafët 15-16 për gjithë aktivet e tjera biologjike.
	Njohja fillestare
9	Një njësi ekonomike duhet të njohë një aktiv biologjik ose një produkt bujqësor vetëm kur: (a) njësia ekonomike kontrollon aktivin / produktin bujqësor si rezultat i ngjarjeve të kaluara; (b) është e mundur që në njësinë ekonomike të hyjë përfitime ekonomike të ardhshme të lidhura me aktivin / produktin bujqësor; dhe (c) vlera e drejtë ose kosto e aktivit / produktit bujqësor mund të matet në mënyrë të besueshme pa kosto ose përpjekje të tepërta.
10	Njohja e aktiveve biologjike bëhet zakonisht në momentin e blerjes. Njohja bëhet gjithashtu kur aktivet biologjike gjenerohen / krijohen nga aktivet ekzistuese. Prodhimi bujqësor, i pandarë (pavjelur, pakorrur, palindur, paqethur, etj) nga një aktiv biologjik, nuk njihet si aktiv më vete.
11	Zakonisht njësia ekonomike bën shpenzime gjatë gjithë jetës së dobishme të një aktivi biologjik. Këto shpenzime kontabilizohen dhe përfshihen si pjesë e vlerës kontabël të aktiveve biologjike, vetëm nëse ato i plotësojnë kriteret e njohjes si aktiv.
	MATJA DHE VLERËSIMI I MËPASHËM
	Matja-modeli i vlerës së drejtë
12	Një njësi ekonomike duhet të masë një aktiv biologjik në njohjen e tij dhe në çdo datë raportimi me vlerën e drejtë të tij minus kostot për shitje. Ndryshimet në vlerën e drejtë minus kostot për shitje duhet të njihen në fitim ose humbje.
13	Produktet bujqësore të përfuara nga aktivet biologjike të një njësie ekonomike, duhet të maten me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes në kohën e vjeljes. Kjo vlerë e matur përbën koston në datën e përfutimit, kur zbatohet SKK 4 <i>Inventarët</i> .
14	Në përcaktimin e vlerës së drejtë, një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë si vijon: (a) Nëse ekziston një treg aktiv për aktivin biologjik ose produktet bujqësore në gjendjen dhe vendndodhjen e tij aktuale, çmimi i kuotuar në këtë treg është baza e përshtatshme për përcaktimin e vlerës së drejtë të atij aktivi. Nëse një njësi ekonomike ka akses në tregje të ndryshme të aktiveve, njësia ekonomike duhet të përdorë çmimin e tregut ku ai pret të shesë. (b) Nëse nuk ekziston ndonjë treg aktiv, një njësi ekonomike përdor një ose më shumë nga sa më poshtë, kur janë të disponueshme, në përcaktimin e vlerës së drejtë: (i) çmimin më të fundit të transaksionit të tregut, duke u siguruar që nuk ka asnjë ndryshim domethënës në rrethanat ekonomike ndërmjet datës të këtij transaksioni dhe datës së raportimit; (ii) çmimet e tregut për aktivet e ngjashme të rregulluara për të reflektuar diferencat; dhe (iii) referencat e sektorit si vlera e një pylli me pemë frutore e shprehur në kuti eksporti, shinikë ose hektarë, dhe vlera e bagëtive e shprehur në kilogramë mish. (c) Në disa raste, burimet e informacionit të listuar në (a) ose (b) mund të sugjerojnë konkluzione të ndryshme për vlerën e drejtë të një aktivi biologjik ose një produkti bujqësor. Një njësi ekonomike merr në konsideratë arsyet e këtyre diferencave, për të arritur në vlerësimin më të besueshëm të vlerës së drejtë brenda një game relativisht të ngushtë të vlerësimeve të arsyeshme. (d) Në disa rrethana, vlera e drejtë mund të jetë menjëherë e përcaktueshme pa kosto apo përpjekje shtesë megjithëse çmimet ose vlerat e përcaktuara të tregut nuk janë të disponueshme për një aktiv biologjik në gjendjen e tij aktuale. Një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse vlera aktuale e flukseve monetare neto të pritshme nga aktivi e skontuar me një normë të caktuar aktuale tregu, rezulton në një matje të besueshme të vlerës së drejtë.
	Matja – modeli i kostos
15	Njësia ekonomike mat me kosto minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi i akumuluar, ato aktive vlera e drejtë e të cilëve nuk është menjëherë e përcaktueshme, pa kosto apo përpjekje shtesë.
16	Njësia ekonomike mat produktet bujqësore të siguruar nga aktivet e saj biologjike me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes në kohën e vjeljes. Një matje e tillë përbën koston e produktit bujqësor në datën e matjes.
	Zhvlerësimi i aktiveve biologjike të mbajtura me kosto
17	Aktivt biologjike, të mbajtura me modelin e kostos, i nënshtrohen testit për zhvlerësim në çdo datë raportimi të pasqyrës së pozicionit financiar.
18	Zvogëlimet për të arritur në vlerën neto të rikuperueshme mund të ndodhin në ato raste kur ka një rënie të çmimeve të shitjes, ose kur shpenzimet e përfundimit apo shpenzimet direkt të shitjeve janë rritur. Ka edhe raste kur disa produkte dëmtohen përpara se të shiten, ose kur disa të tjera mund të mbahen në sasira të tilla që nuk mund të shiten brenda një periudhe kohe të arsyeshme. Në raste të tilla, kostoja e tyre duhet të zvogëlohet për të arritur në vlerën e tyre neto të rikuperueshme.
19	Shuma e zhvlerësimit duhet të përcaktohet zë për zë. Në rastet kur një vlerësim i tillë nuk është praktik, zhvlerësimi duhet të matet për një grup zërash të ngjashëm, ose që kanë lidhje me njëri-tjetrin. Zvogëlimi duhet të marrë parasysh kostot e përlllogaritura për përfundimin dhe shitjen e produkteve, por nuk duhet të përfshijë fitimin që do të krijohet në fazat e

	mëvonshme të prodhimit.
20	Një zvogëlim, i bërë në një periudhë kontabël të mëparshme, duhet të anulohet në ato raste kur kushtet, mbi bazën e të cilave është bërë zvogëlimi, nuk ekzistojnë më.
	Cregjistrimi
21	Aktivitet biologjike çregjistrohen atëherë kur ato shiten. Njësia ekonomike duhet t'i çregjistrojë aktivitet biologjike edhe në ato raste kur ato nuk kanë më vlerë ekonomike për të ardhmen (skartohen ose ngordhin).
	Paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e performancës të aktiveve biologjike
22	Aktivitet biologjike duhet të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar. Ndryshimet në vlerën e aktiveve biologjike paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
	MARRËVESHJET KONÇESIONARE
	Konçesionet e shërbimeve
23	Një marrëveshje konçesionare e shërbimeve është një marrëveshje ku një qeveri ose një organ tjetër i sektorit publik (konçesiondhënësi) kontraktton një operator privat për të ndërtuar (ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur aktivitet e infrastrukturës së konçesiondhënësit si rrugë, ura, tunele, aeroporte, rrjetet e shpërndarjes së energjisë, burgje apo spitale. Në këto marrëveshje, konçesiondhënësi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivitet, kujt duhet t'ia sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënë në aktive në fund të afatit të marrëveshjes.
24	Ka dy kategori kryesore të marrëveshjeve konçesionare të shërbimeve: (a) Në njërin, operatori merr një aktiv financiar—një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të marrë një shumë specifike ose të përcaktueshme fluksesh monetare ose një aktiv tjetër financiar nga qeveria në këmbim të ndërtimit ose përmirësimit të një aktivi të shërbimit publik dhe më pas duke përdorur dhe mirëmbajtur aktivin për një periudhë kohe të specifikuar. Kjo kategori përfshin garanci nga qeveria për të paguar për çdo mungesë ndërmjet shumave të marra nga përdoruesit e shërbimit publik dhe shumave të specifikuara apo të përcaktueshme. (b) Në tjetrën, operatori merr një aktiv jo-material—një të drejtë tarifimi për përdorimin e një aktivi të sektorit publik që ai ndërton ose përmirëson dhe më pas e përdor dhe e mirëmban për një periudhë kohe të specifikuar. Një e drejtë për t'i tarifuar përdoruesve nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të marrë mjete monetare sepse shumat janë të kushtëzuara në masën në të cilën publiku përdor shërbimin. Ndonjëherë, një kontratë e vetme mund t'i përmbajë të dyja llojet: në masën që qeveria i ka dhënë një garanci të pakushtëzuar të pagesës për ndërtimin e aktivitet të sektorit publik, operatori ka një aktiv financiar; në masën që operatori duhet të mbështetet tek publiku për përdorimin e shërbimit në mënyrë që të përftojë pagesën, operatori ka një aktiv jo-material.
	Modeli i aktivitet financiar
25	Operatori duhet të njohë një aktiv financiar në masën që ai ka një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të marrë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar nga ose në drejtimin e konçesiondhënësit për ndërtimin e shërbimeve. Operatori duhet të masë aktivin financiar me vlerën e drejtë. Më tej, ai duhet të ndjekë SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i> .
	Modeli i aktivitet jomaterial
26	Operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licensën) për t'i tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivitet jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkesat e SKK5 <i>Aktivitet afatgjata materiale dhe aktivitet afatgjata jomateriale</i> .
	Të ardhurat operative
27	Operatori i një marrëveshje konçesionare të shërbimeve duhet që, për shërbimin që ai kryen, të njohë, masë dhe deklarojë të ardhurat në përputhje me SKK 8 <i>Të Ardhurat</i> .
	Paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e performancës të marrëveshjeve konçesionare
28	Aktivitet dhe detyrimet që krijohen nga marrëveshjet konçesionare të shërbimeve dhe të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura me to do të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në përputhje me kërkesat e SKK 2, <i>Paraqitja e pasqyrave financiare</i> .
	SHËNIMET SHPJEGUESE
	Shënime shpjeguese për aktivitet biologjike
	Aktivitet biologjike të mbajtura me vlerë të drejtë
29	Në pasqyrat financiare duhet të jepet informacioni i mëposhtëm, në lidhje me aktivitet biologjike të matura me vlerën e drejtë: (a) një përshkrim të çdo klase të aktiveve të saj biologjike. (b) metodat dhe supozimet domethënëse të përdorura në përcaktimin e vlerës së drejtë të çdo kategorie të produkteve bujqësore në kohën e vjeljes dhe çdo kategorie të aktiveve biologjike. (c) një rakordim të ndryshimeve në vlerën kontabël të aktiveve biologjike ndërmjet fillimit dhe fundit të periudhës aktuale. Rakordimi duhet të përfshijë: (i) fitimin ose humbjen që lind nga ndryshimet në vlerën e drejtë minus kostot e shitjes. (ii) rritjet që rezultojnë nga shitjet. (iii) rëniet që rezultojnë nga vjelja. (vi) ndryshime të tjera

	Aktivet biologjike të mbajtura me kosto	
30	Në pasqyrat financiare duhet të jepet informacioni i mëposhtëm, në lidhje me aktivet biologjike të matura me modelin e koston:	
	<p>(a) një përshkrim të çdo klase të aktiveve biologjike.</p> <p>(b) një shpjegim se përse vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme.</p> <p>(c) metodën e përdorur të amortizimit.</p> <p>(d) jetët e dobishme ose normën e përdorur të amortizimit.</p> <p>(e) vlerën kontabël bruto dhe amortizimin e akumuluar (së bashku me humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë) në fillim dhe në fund të periudhës.</p>	
	Shënimet shpjeguese për marrëveshjet konçesionare	
	Modeli i aktivitet financiar	
31	Një njësi ekonomike që zbaton kërkesat e këtij Standardi në lidhje me marrëveshjet konçesionare të shërbimeve që rezultojnë në aktiv financiar, do të japë të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara nga SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i> , si dhe nga SKK 8 <i>Të Ardhurat</i> .	
	Modeli i aktivitet jomaterial	
32	Një njësi ekonomike që zbaton kërkesat e këtij Standardi në lidhje me marrëveshjet konçesionare të shërbimeve që rezultojnë në aktiv jomonetar, do të japë të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara për aktivet afatgjata jomateriale nga SKK 5 <i>Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale</i> , si dhe nga SKK 8 <i>Të Ardhurat</i> .	
	DISPOZITA KALIMTARE	
33	Në vitin e parë të zbatimit të këtij standardi të përmirësuar, njësi ekonomike inkurajohet por nuk kërkohet të zbatojë në mënyrë retrospektivë këtë standard për vlerësimin e aktiveve biologjike me vlerë të drejtë në periudha të mëparshme. Nëse nuk mund të bëhet zbatimi në retrospektivë pa kosto shtesë do të jepen informacione tek shënimet shpjeguese lidhur me politikën e re kontabël të vlerësimit dhe arsyen e moskrahaseshmërisë.	
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	
34	Ky standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ky standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive.	
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME(SNRF PËR NVM)	
35	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM-të . Paragrafët janë konsideruar si korresponduese, nëse ato trajtojnë, në përgjithësi, të njëjtën çështje, pavarësisht nga fakti se përshkrimet në standardet e referuara mund të kenë ndryshim.	
	Paragrafët e SKK 13	Paragrafët e SNRF për NVM botuar në korrik 2009
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Sek 34.1
	Paragrafi 5	Asnjë
	Paragrafi 6	Asnjë
	Paragrafi 7	Asnjë
	Paragrafi 8	Sek 34.2
	Paragrafi 9	Sek 34.3
	Paragrafi 10	Asnjë
	Paragrafi 11	Asnjë
	Paragrafi 12	Sek 34.4
	Paragrafi 13	Sek 34.5
	Paragrafi 14	Sek 36.6
	Paragrafi 15	Sek 34.8
	Paragrafi 16	Sek 34.9
	Paragrafi 17	Asnjë
	Paragrafi 18	Asnjë
	Paragrafi 19	Asnjë
	Paragrafi 20	Asnjë
	Paragrafi 21	Asnjë
	Paragrafi 22	Asnjë
	Paragrafi 23	Sek 34.12
	Paragrafi 24	Sek 34.13
	Paragrafi 25	Sek 34.14
	Paragrafi 26	Sek 34.15
	Paragrafi 27	Sek 34.16

	Paragrafi 28	Asnjë
	Paragrafi 29	Sek 34.7
	Paragrafi 30	Sek 34.10
	Paragrafi 31	Asnjë
	Paragrafi 32	Asnjë
	Paragrafi 33	Asnjë
	Paragrafi 34	Asnjë